

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E
VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS PER SUBJEKTIN:
“IKERAL” SH.P.K



Subjekti : “Ikeral” sh.p.k

Aktiviteti: "Instalimet me djegie"




Vendndodhja: Fshati Nivice, Lukove, Sarande, Vlore

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k



Tirane, 2024

PERMBAJTJA

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedisete caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisore te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti “**Ikeral**” sh.p.k me administrator **Z. Filippas Sapounas** eshte regjistruar prane QKB me NIPT **J64103811M** per ushtrimin e aktivitetit “**Instalime me djegie**”. Aktiviteti zhvillohet ne Qarku Vlore, Bashkia Sarande, Lukove, Fshati Nivice. Subjekti “**Ikeral**” sh.p.k eshte i pajisur me Leje Mjedisi Tipi A, me PN-7007-03-2014, per aktivitetin “**Prodhim i produkteve qeramike nËpËrmjet pjekjes, pËrfshirË tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisË/qeramiks apo tË porcelanit.**”, me vendndodhje Lukove, Sarande, Vlore. Gjate zhvillimit te kËtij aktiviteti, specifikisht gjate procesit te pjekies, ne furrËn e pjekjes, krahas lendes djegËse Kokes operatori do te perdore lende djegËse te tjera alternative. Per kete arsye, operatori po aplikon per tu pajisur me Deklarate Mjeisore per aktivitetin “**Instalime me djegie**” per te patur mundËsinË e pËrdorimit te lendeve djegËse alternative gjate zhvillimit te aktivitetit. Ky aplikimi kryeht sipas Ligji 12.2015 date 26.02.2015 “**PËr disa ndryshime nË ligjin nr. 10 440 datË 7.7.2011**” Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe VKM nr. 686 datË 29.7.2015, “**PËr miratimin e rregullave tË pËrgjegjËsive e tË afateve pËr zhvillimin e procedurËs sË vlerËsimit tË ndikimit nË mjedis (VNM) dhe procedurËs sË transferimit tË vendimit e deklaratËs mjedisore.**

Aktiviteti do te zhvillohet ne Fshati Nivice, Lukove, Sarande, Vlore. Siperfaqja totale e tokes se marre ne perdorim per aktivitetin eshte 25000 m2 duke perfshire kapanonet e punes dhe sheshet e depozitimit te lendes se pares dhe produktit perfundimtare.



Kordinatat e fabrikes ndodhen me poshte :

Nr.	X	Y
1.	4422255.73	4413344.59
2.	4422335.58	4413308.91
3.	4422358.45	4413347.00
4.	4422404.95	4413492.28
5.	4422332.35	4413701.73
6.	4422301.51	4413697.88
7.	4422217.83	4413574.24



Shtrirja e fabrikes eshte me drejtim veriperendim-juglindje. Largesia nga rruga nacionale eshte rreth 700 m. largesia nga gjiri I Kakomese eshte rreth 4 km ne vije ajrore.

Siperfaqja e fabrikes kufizohet :

- Ne veri nga pirgje argjile dhe nga rruge dytesore kantieri
- Ne lindje nga rruge dytesore kantieri ;
- Ne jug rruga qe lidh fabriken me rrugen nacionale Vlore Sarande;
- Ne perendim nga parcela toke;

Fabrika e prodhimit te tullave qeramike Ikeral shpk ka nje kapacitet prodhuwa prej 400 ton tulla te pjekura ne dite. Fabrika shtrihet ne nje siperfaqe prej 25000 m² duke perfshire kapanonet e punes dhe sheshet e depozitimit te lendes se pares dhe produktit. Shoqeria gjithashtu ka ne shfrytezim 2 karriera argjile te ndodhur ne juglindje te fabrikes ne distance prej rreth 600 m nga fabrika.


Procesi teknologjik

Procesi teknologjik i prodhimit te tullave qeramike kalon ne disa faza:

- Shfrytezimi i lendes se pare nga karriera e argjiles (aktiviteti i karrieres se argjiles eshte subjekt i nje leje mjedisore tjeter);

- Perzierjen dhe pergatitjen e brumit
- Prerja e formave
- Pjekja e tullave
- Stokimi

Me poshte po paraqesim ne menyre skematike procesin teknologjik te prodhimit te tullave qeramike :



Pershkrimi i procesit teknologjik :

- ❖ Faza e pare konsiston ne shfrytezimin e lendes se pare nga dy karierat e shoqerise sone per te cilat zoterojme lejet minerale te shfrytezimit dhe lejet mjedisore ne distance 4 dhe 1 Km nga linja e prodhimit. Pas shfrytezimit lenda e pare cohet ne pirgjet e stazhionimit per secilen karriere ku lenda e pare qendron per nje periudhe 6-12 muaj. Ky proces realizohet nga vete shoqeria jone.



Fig.1 Foto nga kariera e argjiles

- ❖ Faza e dyte konsiston ne bluarjen, perpunimin dhe perzierjen e lendes se pare. Ky proces fillon me mbushjen e ushqyesve 1 dhe 2 me argjila te marre nga pirgu i stazhionimit te ndara sipas karierave, pasi jane dy tipe te ndryshme argjilash. Sasia e argjiles 1 dhe 2 se bashku arrin kapacitetit maksimal 500 ton ne dite. Tek ushqyesi numer 3 hidhet nje sasi e caktuar lende djegese e cila sherben per te rritur cilesine e lendes se pare dhe per te realizuar nje pjekje me te mire dhe me me pak lende djegese gjate procesit te mevonshem te pjekjes duke reduktuar sasine e CO2 qe shkarkohet ne ajer. Shoqeria jone bashkepunon me institucionet perkatese te kontrollit per te mundesuar nje cilesi me te mire prodhimi, ku ka arritur ne konkluzione te rendesishme per perdorimin e lendeve ndihmese te cilat me riperdorimin e tyre do te sjellin nje ndikim pozitiv ne mjedis, duke i kthyer ato nga mbetje ne produkte ndihmese.

Per realizimin e kesaj faze:

1. Sherben linja e lendes se pare duke filluar me ushqyesit e lendes se pare dhe ushqyesi i lendes alternative, te cilat bejne perzierjen e ketyre lendeve ne baze te raporteve te caktuara. Sipas fig.1



2. Procesi i themimit te lendes se perzier nepermjet thyersave nr. 1 dhe 2 sipas fig 2



3. Petezimi i perzierjes ndermjet cilindrave nr 1 dhe nr 2 deri ne masen me te vogel se 1mm. fig 3



4. Procesi i banjezimit me ane te banjatoreve 1 dhe 2 fig 4



5. Procesi i presimit te perzierjes dhe dalja e produktit tulle gjysem e gatshme me 15% lageshtire me pas kalojme ne procesin e tharjes dhe pjekjes se produktit perfundimtar.Fig 5



Mbetjet qe mund te perdoren ne fazen e dyte jane si me poshte:

01 03 08	Mbetje pluhurash, pervec atyre te permendura ne rubriken 01 03 07
01 03 09	Mbetje (ne forme balte te kuqe) e dale nga prodhimi i aluminit, te tjera nga ato te permendura ne 01 03 10
01 04 13	Mbetje qe vijne nga prerja dhe sharrimi i gureve, te tjera nga ato te permendura ne 04 07
01 04 99	Mbetje te tjera te paspecifikuara
02 03 99	Mbetje te tjera te paspecifikuara
05 01 99	Mbetje te tjera te paspecifikuara
06 01 99	Mbetje te tjera te paspecifikuara
06 09 04	Mbetje te reaksioneve me baze kalciumi, te tjera nga ato te permendura ne 06 09 03
06 10 99	Mbetje te tjera te paspecifikuara 10 01 01 Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash (perjashtuar pluhurin e kaldajave te permendur ne 1001 04)
10 01 01	Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash (perjashtuar pluhurin e kaldajave te permendur ne 10 01 04)
10 01 02	Hi fluturues
10 01 03	Hi fluturues nga torfat dhe druri I patrajtuar
10 01 05	Mbetje te reaksioneve me baze kalciumi nga desulfurimi i gazit te oxhakeve ne gjendje te ngurte
10 01 07	Mbetje te reaksioneve me baze kalciumi nga desulfurimi i gazit te oxhakeve ne gjendje llumi
10 01 15	Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash si rezultat I bashkedjegies, te tjera nga ato te permendura ne 10 01 14
10 01 17	Hi fluturues nga co-icenerimi, te tjera nga ato te permendura ne 10 01 16
10 02 01	Mbetje nga perpunimi I skorieve nga hekuri (ILS)
10 02 02	10 02 02 Skorie e pa perpunuar (Blast Furnace Slag – BSF)
10 02 08	Mbetje te ngurta nga trajtimet e gazeve, te tjera nga ato te permendura ne 10 02 07
10 02 10	Smerc nga mulliri
10 02 99	Mbetje te tjera te paspecifikuara
10 03 05	Mbetje te aluminit
10 03 16	Shkuma, te tjera nga ato te permendura ne 10 03 15
10 06 01	Zgjyra nga prodhimi primar dhe dytesor
10 12 03	Pjese te imeta dhe pluhura nga prodhimi i qeramikes, tullave
10 12 06	Kallepe skarco
10 12 08	Mbetje qeramike, te tullave, tjegullave, pllakave dhe produkteve te ndertimit (pas perpunimit termik)
10 12 12	Mbetje nga emalimi dhe smaltimi, te tjera nga ato te permendura ne 10 12 11
10 12 99	Mbetje te tjera te paspecifikuara
10 13 01	Mbetje nga perzierjet e pergatitura perpara perpunimit termik
10 13 06	Pjese te imeta dhe pluhura (perjashtuar 10 13 12 dhe 10 13 13)
10 13 14	Mbetje te betonit dhe numra te betonit
12 01 17	Mbetje te materialeve shperthyese, te tjera nga ato te permendura ne 12 01 16
15 01 07	Mbetje ambalazhi qelqi
16 01 17	Metale ferore (OKT'Z)
16 01 20	Qelq
16 08 03	Katalizatore te harxhuar qe permbajne metale tranzit ose komponime te metaleve te tranziteve te tjere
16 08 04	Katalizatore fluide te harxhuar (pervec 16 08 07)
16 11 04	Mbetje te veshjeve te brendshme dhe materialeve zjarrduruese nga procese

	metalurgjike, te tjera nga ato te permendura ne 16 11 03
16 11 06	Mbetje te veshjeve te brendshme dhe materialeve zjarrdurese nga proceset jometalugjike, te tjera nga ato te permendura ne 16 11 05
17 01 02	Tulla
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika
17 01 07	Perzierje te betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikes, te tjera nga ato te permendura ne 17 01 06
17 02 02	Qelqe
17 05 04	Dhera dhe gure, te tjera nga ato te permendura ne 17 05 03
17 05 06	Balta, te tjera nga ato te permendura ne 17 05 05
17 05 08	Çakell, te tjera nga ato te permendura ne 17 05 07
17 08 02	Materiale ndertimi me gips, te tjera nga ato te permendura ne 17 08 01
17 09 04	Mbetje te perziera nga ndertimi dhe te prishjeve, te tjera nga ato te permendura ne 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03
19 02 03	Mbetje te perziera paraprakisht, te kompozuara vetem nga mbetje te parrezikshme
19 03 05	Mbetje te stabilizuara te tjera nga ato te permendura ne 19 03 04

- ❖ Faza e trete konsiston ne mbushjen e vagonave te tharjes me tulla te njoma gjysme te gatshme te cilat kalojne ne procesin e tharjes ku lageshtia e tulles nga 15 % shkon ne 0%. Per realizimin e tharjes se tullave perdoren ajri i nxehte qe clirohet nga tullat e pjekura ne furra dhe percillet me ane te ventilatorit ne sallën e tharjes. Gjatesia e tuneleve te tharjes eshte 80 metra, gjeresia eshte 20 metra dhe lartesia 4 metra. Ne sallën e tharjes jane instaluar ventilatore te vegjel te cilet bejne ventilimin dhe tharjen e tullave. Temperatura ne hyrje eshte 25 grade celcius dhe ne dalje 100 grade celcius. Lageshtia del me ane te ventilatoreve te lageshtise. Vagonat me tulla te thata kalojne tek ashensori i shkarkimit dhe behet transportimi i tyre per tek paketuesja e tullave per tek vagonat e furrave.



Fig.3 Vagonet e tharjes

❖ PJEKJA E PRODHIMIT

Faza e katert konsiston ne pjekjen e tullave. Instalimi me djegie sic u specifikua dhe me larte, ben pjes ne fazen e katert ne pjekien e tullave, ku krahas qymyrit kokse do te perdoren dhe lende te tjera alternative te cilat jane te listuara si me poshte.

Furrat kane gjatesi 120 metra, gjeresi 4.6 metra dhe lartesi 2.3 metra. Kapaciteti maksimal 45 vagona, temperature e pjekjes arrin deri ne 980 grade celcius. Pjekja realizohet me ane te lendes djegese Koks i cili i ushtrohet perpunimit, thermimit dhe transportohet per ne furra nepermjet impiantit te tubacioneve se bashku me ajrin e paster me ane te ventilatorit. Shkarkimi i gazeve ne atmosfere behet me ane te oxhakut te furrave me lartesi 18 metra. Në fazën e 4 të procesit të pjekjes së tullave bashkë me qymyrin koks mund te perdoren edhe lende të tjera alternative (mbetje) ne nje sasi per rreth 5 ton ne dite ne varesi te fuqise kalorifike te seciles lende alternative mbetje qe do te perdoret. Ky process fillon qe nga procesi I bluarjes dhe perzierjes se lendes alternative mbetje me qymyrin koks. Pergatitja e Lendes djegese alternative kalon neper disa etapa:

- Coptuesi kryesor

Coptuesi perbehet nga:

- Depozita, perfshin pajisjen prerese me thikat me dy presa
- Rotorin me thika
- Motorri elektro-hidraulik
- Pajisja e kontrollit

-Ndaresi metalik

Pjeset e magneteve jane te vendosura ne te dyja anet e levizjes se materialeve. Pjeset jo metalike bien ne konvenier, ndersa pjeset metalike kapen nga magnetet dhe orientohen ne nje konvenier devijues ku kalojne metalet dhe papastertite e tjera te seleksionuara nga magnetet.

-Sita

Sita perdoret per te ndare te gjitha papastertite me permasa me te vogla se 30 mm. Sita eshte e sheshte me nje shkallezim qe ndan siten ne disa elemente per shpemdardje me te mire te materialeve ne te gjithë gjerësine e saj.

- Ndaresi per materialet e panevojshme

Materialet me te lehta qe do te kalojne ne kete ndares do te kalojne ne coptuesin e dyte dhe do te transportohen me rryme ajeri ne nje kolektor dhe me tej ne nje konvenier.

- Coptimi i imet/i dyte

Coptimi i imet eshte faza perfundimtare e pergatitjes se Lendes djegese alternative. Coptuesi i imet konsiston ne:

- Kafazi qe perfshin boshtin me thikat me dy tehe
- Boshtin me thika
- Sistemi i shtyerjes
- Elektromotorri
- Pajisjet e kontrollit
- Tubi i hyrjes

-Magazinimi i materialeve te coptuar te gatshem perLDA.

Materialet e seleksionuara zakonisht transferohen me konvenier nga kapanoni i Lendes djegese alternative per ne tubin me helik turjel te brendshme qe eshte edhe pika e transportit pneumatik per ne sillos.

-Pajisjet e transportit

Per transportin e materialeve perdoren pajisje te ndryshme si:

- Konvejeret me rrip
- Pajisjet e levizshme
- Sistemi i kapjes se pluhurave

Pas ketyre proceseve te bluarjes deri ne forme pluhuri (pudre) presohet me ane te ventilatoreve se bashku me ajer ne impianti qe ndodhet mbi furren e pjekjes dhe me pas injektohet ne furrat e pjekjes. Tempera ne furren e pjekjes arrin 950 – 980 grade celcius ne varesi te llojit te tullave qe do te piqen. Me poshte paraqitet makineria qe perdoret per procesin e pjekjes.



Makineria e bluarjes nr 1.

- ❖ Lendet e tjera alternative te cilat perdoren sebashku me qymyrin e koksit per procesin e pjekjes

02 01 02	Mbetje nga indet e kafshëve
02 01 03	Mbetje të indeve bimore
02 01 04	Mbetje të lëndëve plastike (me përjashtim të ambalazheve)
02 01 07	Mbetje që vijnë nga pylltaria (silvikultura)
02 01 09	Mbetje bujqësore, përveç atyre të paraqitura në rubrikën 02 01 08
02 02 02	Mbetje që vijnë nga indet shtazore
02 03 04	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
02 05 01	Lëndë të papërshtatshme për konsum apo përpunim
02 07 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
05 01 10	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 05 01 09
05 01 17	Përzierje bituminoze

10 03 18	Mbetje nga prodhimi i anodave që përmbajnë karbon, të tjera nga ato të përmendura në 10 03 17
15 01 03	Mbetje ambalazhi druri
15 01 05	Mbetje ambalazhi të përbëra
15 01 06	Mbetje ambalazhi
15 01 09	Mbetje ambalazhi tekstili
15 02 03	Absorbente, materiale filtrues, copa rroba thithëse, të tjera nga ato të përmendura në 15 02 02
16 01 03	Goma jashtë përdorimit
16 01 19	Plastika
17 02 01	Dru
17 02 03	Plastikë
17 03 02	Përzjerje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01
19 02 03	Mbetje të përziera paraprakisht, të kompozuara vetëm nga mbetje të parrezikshme
19 05 01	Fraksione të pakompostuara të mbetjeve urbane dhe mbetjeve të tjera të ngjashme
19 05 02	Fraksione të pakompostuara të mbetjeve bimore dhe shtazore
19 05 03	Kompost jashtë specifikimit
19 05 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
19 12 10	Mbetjet e djegshme (skarcitetet e lëndëve djegëse)
19 12 01	Letër e karton
19 12 04	Plastik gomë
19 12 07	Drurë të tjerë nga ato të përmendura në 19 12 06
19 12 08	Tekstilet
19 12 10	Mbetjet e djegshme (skarcitetet e lëndëve djegëse)
19 12 12	Mbetje të tjera (përfshirë materiale të përziera) nga trajtimi mekanik I mbetjeve, të tjera nga ato të përmendura në 19 12 11
20 01 01	Letër dhe karton
20 01 39	Plastikët
05 01	Mbetje që vijnë nga rafinimi i naftës
05 01 10	Llumra që vijnë nga trajtimi në vend i rrjedhjeve të tjera nga ato të përmendura në 05 01 09
05 01 13	Llumra të dala nga trajtimi i ujit ushqyes të kaldajave
05 01 14	Mbetjet që vijnë nga kolonat e ftohjes
05 01 16	Mbetjet që përmbajnë squfur të dala nga procesi i desulfurimit të naftës

05 01 17	Përzierje bituminoze
05 01 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara
05 06	Mbetjet e dala nga trajtimi pirolitik i qymyreve
05 06 04	Mbetje të dala nga kolonat e ftohjes
05 06 99	Mbeturina të tjera të paspecifikuara
05 07	Mbetje të dala nga pastrimi dhe transporti i gazit natyror
05 07 02	Mbetje që përmbajnë squfur
05 07 99	Mbetje të tjera të paspecifikuara

- ❖ Faza e peste konsiston me shkarkimin e vagonave të pjekjes, vendosjen e tullave në paleta druri dhe me pas amballazhimin e tyre me plasmas. Me pas transportohen nga pirunat në sheshin e magazinimit. Furnizimi me uje realizohet nga një pus shpimi 70 metra thellesi i cili mbush depoziten e ujit e cila ndodhet mbi nivelin e fabrikes. Sasia e ujit që përdoret është rreth 30 m³ në ditë dhe nuk ka shkarkime të ujrave.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Fabrika e prodhimit të tullave të shoqërisë IKERAL shpik ndodhet në fshatin Nivice, në krahun e djathtë të rruges nacionale Sarandë - Vlorë Km 10, komunën Lukovë të rrethit të Sarandës, prefektura Vlorë. Shtrirja e fabrikes është me drejtim veriperëndim -juglindje. Largesia nga rruga nacionale rreth 700 m. Largesia nga gjiri i Kakomës rreth 4 km në vijë ajerore.

Vlora ndodhet përgjatë brigjeve shqiptare të detit Adriatik dhe Jon në pjesën lindore të ngushticës së Otrantos, e rrethuar nga ultësirat e maleve Cerauniane. E përcaktuar në një sipërfaqe prej 647,94 km², Bashkia Vlorë përfshihet në qarkun e Vlorës si pjesë e Rajonit Jugor të Shqipërisë dhe përbëhet nga njësitë administrative ngjitur Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë, Shushicë dhe Vlorë. Bashkia shtrihet nga gryka e Vjosës në veri përgjatë Lagunës së Nartës deri në Qafën e Llogarasë në jug. Ai gjithashtu rrethon gadishullin e Karaburunit dhe ishullin e Sazanit në perëndim me lumin Shushicë-Vlorë që përbën kufirin e tij lindor. Zonat e mbrojtura përfshijnë Parkun Detar Karaburun-Sazan, Parkun Kombëtar të Llogarasë dhe Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë. Bashkia Sarandë përfshihet në qarkun e Vlorës si pjesë e Rajonit Jugor të Shqipërisë dhe përbëhet nga njësitë administrative ngjitur me Ksamilin dhe Sarandën. Sipërfaqja e përgjithshme e saj është 58,96 km².

❖ Klima

Vlora bie nën periferinë e zonës së klimës mesdhetare të verës së nxehtë me një temperaturë mesatare vjetore prej 16,9 °C. Vera në Vlorë është e thatë dhe e nxehtë ndërsa dimrat përjetojnë temperatura mesatare dhe mot të ndryshueshëm me shi. Muaji më i ngrohtë është gushti me një temperaturë mesatare që rritet në 26,8 °C . Në të kundërt, muaji më i ftohtë është janari me një temperaturë mesatare që bie në 7,9 °C (46,2 °F). Vlora ka një klimë me diell me një mesatare prej 3,358 orë me diell në vit, duke e bërë atë një nga zonat më me diell në Mesdheun Lindor.

Relievi i bute ka pamjen e nje pllaje te valezuar, vende-vende pak te thyer me lugina te buta te formuara nga prroskat e rrjedhjes se ujrave atmosferike. Zona eshte ne pergjithesi e pasur me ujra, prane kalon lumi Erzen qe derdhet ne dete dhe jane ndertuar disa ujembledhesa te cilet plotesojne kerkesat e komunitetit per ujitjen e tokave bujqesore.

❖ Flora dhe fauna

Pyjet e zones ofrojne mjedise te favorshme per rritjen e bimeve dhe kafsheve te ndryshme. Kultivohen bime te ndryshme bujqesore si perime, drithera, kultura foragjere etj, gjithashtu kultivohen druret frutore te zones se Mesdheut si: agrumet (portokallet, limonat, mandarinat) dhe ullinjte. Vreshtaria ze vend paresor.

Bimet barishtore dhe eterovajore qe sherbejne ne mjekesine popullore dhe farmaceutike shtrihen nga zona fushore e deri ne ate malore.

Ne zonen e shkurreve rritet valanidhi dhe perralli, te njohur per vlerat kurative.

Ne lartesine 800m mbi nivelin e detit, shtrihet zona e dushkut. Mbi 800m mbi nivelin e detit gjendet zona e pishave dhe bredhit si dhe bushi e shtogu.

Kullotat subalpine gjenden ne lartesine 700-1800m.

Fauna dhe eritrofauna eshte e pasur ne lloje ne gjithe zonen: sorkadhja, derri i eger, ujku, cakalli dhelpra, lepuri i eger (sidomos ne pyllin e Llogorait), eritrofauna e pasur si ne toke ashtu edhe ne ujera: qukapiku, harabeli, mellenja, laraska, zhgaba, skifteri, petriti, thellezat, pellumbat e eger, shapkat (liqeni i Orikumit). Jo rralle shfaqen dhe delfinet e Mesdheut.

Zona e Vlores pret te pakten 33 lloje qe meritojne mbrojtje prej te cileve 14 te vleresuar si te rrezikuar per t'u zhdukur, si foka murgeshe mesdhetare (Monachus Monachus), breshka (Caretta Caretta), tritoni i kreshperuar (Triturus Cristatus) pelikani me krrela (Pelecanus Crispus), shqipja me bllama (Aquila clanga). Ne dimer me shume se 23% e gjithe zogjve ujore te Shqiperise strehohen ketu.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

Duke gene se instalimi me djegie ka gene dhe eshte pjese e fabrikes se prodhimit te tullave, rrjedhimisht prezenca e ndikimeve lidhet me aktivitetin kryesore i cili eshte fabrika e prodhimit te tullave.

• **Ndikimet ne popullsi**

Ushtrimi i aktivitetit do te kryhet larg zonave te banuara, rreth 2.03 km nga banesa me e afert. Vendi ku do te zhvillohet aktiviteti nuk sjell shqetesime per ta vecse rrit mundesine e punesimit te tyre, duke rritur keshtu nivelin ekonomik te ketyre familjeve qe ndodhen ne fshatin prane. Duke gene se subjekti operon prej shume vitesh ne kete vendndodhje, numeron nje numer te konsiderueshem punonjesish te punesuar nga zona e banuar me e afert.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat qe krijohen ne aktivitet jane si rezultat i levizjes se makinerive qe perdoren per transportimin e lendeve qe do te hyjne ne furren e pjekies si lende alternative, gite procesit te funksionimit te instalimit me djegie per pjekien e tullave si dhe nga mjetet e transportit. Nga zhvillimi i ketij procesi emetohen zhurma te matshme, niveli i zhurmave eshte i njejte me cdo proces prodhimi te ngjashem dhe brenda normave te lejuara. Duke qene se subjekti ndodhet ne nje largesi te konsiderueshme nga zonat e banuara, zhvillimi i ketij aktiviteti nuk perben shqetesim per banoret e zones perreth.

- **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ka shkarkime ne ujera pasi nuk ka perdorim te ujit ne asnje pik te procesit te saj. Lendet e para qe do te perdoren si lende alternative nuk do te jene ne sasi te medha. Ato do te sistemohen ne ambientet e brendshme te fabrikes se prodhimit te tullave te cilat jane te asfaltuara. Nga magazinimi ne brendesi te ambienteve te vendosura te pershtatshme per magazinimin e ketyre mbetjeve jo te rrezikshme te cilat perdoren si lende alternative ne furren e pjekies se tullave, nuk do te kete ndikime negative ne cilesine e burimeve ujore siperfaqesore apo nentokesore ne rastin e reshjeve atmosferike. Ne fabriken e prodhimit te tullave, jane te instaluara te gjitha ulluqet per kanalizimin e ujrave te shiut. Nuk do te kete ndikim as ne menyre direkte dhe indirekte ne cilesine e ujrave siperfaqesore apo nentokesore apo te cdo trupi ujore ne afersi ku vendndodhja e aktivitetit ka nje distance prej 3.38 km nga Lumi i Kalase dhe 2.43 km nga ujembledhesi i Gajdarit. Kjo distance eshte mese e konsiderueshme dhe ndikimet jane teresisht te paperfillshme.

- **Ndikimet ne toke**

Duke qene se ambjentet e brendshme te zhvillimit te ketij aktiviteti jane konstruktuar sipas te gjitha parametrave bashkekohore te teknologjise, shmange cdo mundesie ndotese te tokes (truallit) mbi te cilin eshte ngritur aktiviteti. Te gjitha ambientet e brendshme te linjes jane te shtruara dhe te izoluara me se miri. Gjithashtu koksi dhe te gjitha lendet te cilat do te perdoren si lende djegese alternative, do te depozitohen sipas parametrave te duhura, ne ambjent te mbyllur brenda kapanonit te argjiles, gje e cila eviton ndotjen e tokes e cila mund te shkaktohej ne rastin e depozitimit te tyre ne ambjent te hapur, sidomos ne rast reshjesh te cilat do te shkatonin ndotje te ujrave nentokesore.

- **Ndikimet ne ajer**

Duke qene se kemi te bejme me nje aktivitet karriere, kemi nje gjenerim te pluhrave ne ajer por qe nuk shkaktojne ndotje te nje niveli shqetesues. Per ta evituar, here pas here subjekti ben sperkatje me uje te territorit.

- **Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare**

Nga zhvillimi i aktivitetit, ne zonen ku zhvillohet dhe territorin per rreth, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne

brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

- **Ndikimet ne ekonomi**

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky aktivitet ka sjell ndikime pozitive ne ekonomi duke rritur te ardhurat jo vetem te investitorit por duke punesuar edhe punonjes nga zona perreth duke rritur nivelin e tyre te jeteses.

4. MASAT PER ELEMINIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen, shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marre masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Masat qe duhen marre per eleminimin/minimizimin e ndotjeve.

Ndikimi i mundshem	Masat e marra
1 Ndikimet ne toke	Duke qene se ambjenet e brendeshme te zhvillimit te ketij aktiviteti jane konstruktuar sipas te gjithe parametrave bashkekohore te teknologjise, shmange cdo mundesi ndotese te tokes (truallit) mbi te cilin eshte ngritur aktiviteti. Te gjithe ambientet e brendshme te linjes jane te shtruara dhe te izoluara me se miri. Gjithashtu koksi dhe te gjitha lendet te cilat do te perdoren si lende djegese alternative, do te depozitohen sipas parametrave te duhura, ne ambient te mbyllur brenda kapanonit te argjiles, gje e cila eviton ndotjen e tokes e cila mund te shkaktohej ne rastin e depozitimit te tyre ne ambient te hapur, sidomos ne rast reshjesh te cilat do te shkatonin ndotje te ujrave nentokesore.
2 Humbja e tokes per kullote	Siperfaqe e pergjithshme qe ze objekti nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson ndonje kullote.
3 Ngjeshje e pjeseshme e tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe te automjeteve te transportit si kamione etj.	Ngjeshja e tokes nga mjetet e punes gjate aktivitetit si dhe nga levizja e mjeteve te transportit te produktit fillestar e perfundimtar.

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve negative ne ajer

Ndikimi i mundshem

Masat e marra

1 Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga	Saisa e gazeve e NOx dhe SOx qe do te
---	---------------------------------------

automjetet, ngarkim transportit.

shkarkohet eshte standart i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara. Mjetet jane te kolauduara dhe shkarkimet e kesaj natyre jane minimale.

2 Shkarkimet nga burimi stacionar

Si rezultat i zhvillimit te ketij aktiviteti burim shkarkimesh ne ajer gjate procesit te prodhimit do te kemi shkarkime gazesh nga oxhaket e furreve te pjekies se tullave, gaze si NO_x, SO₂, CO, CO₂. Per minimizimin e shkarkimeve te gazeve subjekti ka instaluar filtra ne oxhak. Gjithashtu nga procesi ka edhe shkarkime avujsh nga oxhaket e aspiratoreve te dhomave te tharjes se tullave.

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve negative ne uje

Ndikimi i mundshem

Masat e marra

1 Shkarkimet e ujrave

Ne teknologjine e zhvillimit te ketij aktiviteti nuk ka perdorim te ujit.

2 Ndikimi i cilesise se ujrave

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ka shkarkime ne ujera pasi nuk ka perdorim te ujit ne asnje pik te procesit te saj. Lendet e para qe do te perdoren si lende alternative nuk do te jene ne sasi te medha. Ato do te sistemohen ne ambientet e brendshme te fabrikes se prodhimit te tullave te cilat jane te asfaltuara. Nga magazinimi ne brendesi te ambienteve te vendosura te pershtatshme per magazinimin e ketyre mbetjeve jo te rrezikshme te cilat perdoren si lende alternative ne furren e pjekies se tullave, nuk do te kete ndikime negative ne cilesine e burimeve ujore sipërfaqesore apo nentokesore ne rastin e reshjeve atmosferike. Ne fabriken e prodhimit te tullave, jane te instaluara te gjitha ulluqet per kanalizimin e ujrave te shiut. Nuk do te kete ndikim as ne menyre direkte dhe indirekte ne cilesine e ujrave sipërfaqesore apo nentokesore apo te cdo trupi ujore ne afersi ku vendndodhja e aktivitetit ka nje distance prej 3.38 km nga Lumi i Kalase dhe 2.43 km nga ujembledhesi i Gajdarit. Kjo distance eshte mese e konsiderueshme dhe ndikimet jane teresisht te paperfillshme.

Masat e marra per minimizimin e ndikimeve ne floren e zones

Ndikimi i mundshem

1 Shqetesim i flores ne zone

Pasojat ne mjedis

Siperfaqja e aktivitetit dhe zona perreth saj eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht dhe fauna eshte e varfer proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Siperfaqja do te mbillet me bime lokale ne momentin kur te behet rehabilitimi i siperfaqes. Rehabilitimi behet ne menyre progresive.

Masat e marra per menaxhimin e mbetjeve te ngurta

Ndikimi i mundshem

1 Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor

Pasojat ne mjedis

Kartona, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve.

Leter dhe karton- 20 01

Mbetje te biodegradueshme-20 01 08

Plastikat- 20 01 39

Keto mbetje do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga drejtuesit e shoqerise per tu derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

- Gjate zhvillimit te aktivitetit kryesor te shoqërisë i cili eshte prodhimi i tullave, specifikisht gjate procesit te pjekies, ne furrën e pjekjes, krahas lendes djegëse Kokes operatori do te perdore lende djegëse te tjera alternative. Per kete arsye, operatori po aplikon per tu pajisur me Deklarate Mjeisore per aktivitetin “Instalime me djegie” per te patur mundësinë e përdorimit te lendeve djegëse alternative gjate zhvillimit te aktivitetit.
- Duke qene se instalimi me djegie ka qene dhe eshte pjese e fabrikes se prodhimit te tullave, rrjedhimisht prezenca e ndikimeve lidhet me aktivitetin kryesor i cili eshte fabrika e prodhimit te tullave.
- Lendet e para qe do te perdoren si lende alternative nuk do te jene ne sasi te medha. Ato do te sistemohen ne ambientet e brendshme te fabrikes se prodhimit te tullave te cilat jane te asfaltuara. Nga magazinimi ne brendesi te ambienteve te vendosura te pershtatshme per magazinimin e ketyre mbetjeve jo te rrezikshme te cilat perdoren si lende alternative ne furren e pjekies se tullave, nuk do te kete ndikime negative ne cilesine e burimeve ujore siperfaqesore apo nentokesore ne rastin e reshjeve atmosferike.
- Zhurmat qe krijohen ne aktivitet jane si rezultat i levizjes se makinerive qe perdoren per transportimin e lendeve qe do te hyjne ne furren e pjekies si lende alternative, gjte procesit te funksionimit te instalimit me djegie per pjekien e tullave si dhe nga mjetet e transportit.

Rekomandime

- Te merren masa dhe te kryhet rehabilitimi i mjedisit ne rastet e ndonje aksidenti.
- Te kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike te agregateve dhe mjeteve te transportit.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, vibrimet etj në jetën e tyre të përditshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.
- Te largohen te gjitha mbetjet e ngurta qe krijohen si rezultat i aktivitetit njerezor ne vendet e percaktuara nga pushteti lokal.